

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i pergjithëshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit M. K., nga fshati L. e p., Komuna e Prizrenit, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore ne Prizren PP.nr.969/2014 të datës 17.03.2015 për shkak të veprës penale të ngacmimit nga neni 186 par.1 të KP-ës, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-së, për dhënien e urdhrit ndëshkimor me datë 28.12.2015, muarr këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M. K., nga i ati F., dhe nëna F. me mbiemër vajzërisë A., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Prizren, me vendbanim në fshatin L.e e P., Komuna e Prizrenit, student, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 25.12.2013 rreth orës 22,30 në Prizren në fshatin L. e P. është përfshirë në një gjendje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon dhe e vë në vëzhgim me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit të dëmtuarën- K. A., në atë mënyrë që i pandehuri kishte shkuar në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarës duke i goditur rrethojat e oborrit dhe duke lehur si qen, e dëmtuara kishte dëgjuar zhurmën e rrethojave dhe kishte dalë që të shikojë se kush ishte dhe te dera hyrëse e shtëpisë poshtë nën shkallë kishte vërejtur një person të maskuar me një pistoletë plastike i cili e kishte spërkatur me një lëngë në fytyrë të dëmtuarën, me ç' rast tek e dëmtuara shkakton shqetësim të madhe emocional,

- këso dore ka kryer veprën penale të ngacmimit nga neni 186 par.1 të KP-ës.

- Andaj, gjykata me aplikimin e dispozitave të nenit 4, 41, 43 par. 1 pika 1.3, nenit 46, 73 të KP-ës dhe neni 495 të KPP-ës shqipton:

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

- **PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.969/2014 të datës 17.03.2015

Të akuzuarit **M. K.**, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 200 € (dyqind) euro, të cilin denim i akuzuari duet të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij

aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të zavendesohet me dënim burgimi duke llogaritur për çdo 20 € një ditë burg.

E dëmtuara K. (D.) A., nga fshati L. e P., Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pronësoro juridike udhëzohet në kontest të rregulltë civil.

I akuzuari obligohet që të paguajë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20,00 euro, të gjitha në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate, i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2179/2014 të datës 18.03.2015, kundër të akuzuarit M. K., nga fshati L. e P., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale të ngacmimit nga neni 186 par.1 të KP-ës, dhe kërkesën për lëshimin e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë me arsyetim se janë siguruar të dhëna të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale i cila i vihet në barë dhe janë plotësuar kushtet ligjore kon forme nenit 493 të KPP-ës për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit të kërkesës të PTH-ës në Prizren për dhënien e urdhrin ndëshkimor konstatoi se ka të dhënat mjaftueshme të cilat ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor, andaj gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore dhe mori vendim që të pranoj propozimin për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kjo gjykatë konsideron se nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë në raportin e oficerit me nr.2013-GA-3897, të datës 27.12.2013, të përpiluar nga oficeri S. B., në deklaratën e të dëmtuarës, dhe të pandehurit të dhënë në proce3durën paraprake pranë stacionit policor në Prizren, si dhe nga shkresat e tjera të lëndës vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale i cila i vihet në barë.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në nenin 450 të KPP-ës.

Vendimin mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në nenin 463 par.1 të KPP-es,

Me sa u tha më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimit

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN P.nr.546/2015 me datë 28.12.2015.

**Procesmbajtësja
Naxhis Sharani**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Luan Berisha**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit, në këtë gjykatë. Po qesë i pandehuri nuk ushtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.

